



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE

SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE
Njësia Kërkimore "Pasuritë Ujore"

Lënda: Ftesë për pjesëmarrje në veprimtari shkencore

Të nderuar kolege,

Në emër të Njesisë Kërkimore "Pasuritë Ujore" pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ju ftojmë të merrni pjesë në Workshopin "Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t'iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave", që do të mbahet në datën 29 shkurt 2024, në sallën "Aleks Buda" në Akademinë e Shkencave.

Qëllimi i këtij aktiviteti është evidentimi i punës kërkimore-shkencore në fushën e menaxhimit të ujërave, me qëllim forcimin e bashkëpunimit midis grupeve dhe mundësimin e kërkimeve ndërdisiplinore, për t'iu përgjigjur sfidave reale të sektorit.

Pjesëmarrja Juaj në këtë aktivitet, ju jep mundësinë të prezantoni punën tuaj dhe të evidentoni arritjet e synimet për të ardhmen. Mendojmë që pjesëmarrja në këtë rrjet kërkuesish dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet grupeve kërkimore, do të rrisi mundësinë e bashkëpunimit dhe përfshirjes tuaj në projekte apo studime shkencore, duke mundësuar një integrim më të mirë të komunitetit shkencor në zgjidhjen e problemeve aktuale të sektorit të ujërave në Shqipëri e rajon.

Bashkëngjitur do të gjeni agjenden dhe një format prezantimi me disa çështje orientuese, të cilit mund t'i referoheni për prezantimin tuaj. Për të na mundësuar një organizim sa më të mirë të këtij aktiviteti, ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj dhe mundësinë për të prezantuar shkurt punën e grupit kërkimor që drejtoni (ose jo). Ju lutemi, që konfirmimin t'a bëni në adresën (eljorasema@gmail.com) deri në 20 shkurt 2024. Ju lutemi mënjaroni prezantime të shumëfishta nga i njëjti grup kërkimor.

Theksojmë, që në këtë aktivitet janë të ftuar dhe të mirëpritur të gjithë kolegët e interesuar, pavarësisht nëse vendosin të prezantojnë ose jo. Diskutimet dhe mendimet tuaja janë të domosdoshme për krijimin e rrjetit dhe perbejnë bazën e një bashkëpunimi të suksesshëm.

Shpresojmë, që së bashku të realizojmë një aktivitet interesant dhe frytdhënës!

Me respekt

Grupi organizator i Njesisë Kërkimore "Pasuritë Ujore"